



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2609/5 prot.

Datë 16.12.2022

V E N D I M
Nr. 1262/2022

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Kreshnik Tërnova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 16.12.2022 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Elba – Oil 2015” SHA në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-46826-10-20-2022, me objekt: Loti II “Blerje Vaj, Antifrizë dhe Alkol për automjete”, me fond limit 1.030.000 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 04.11.2022 nga autoriteti kontraktor, Posta Shqiptare SHA.

Ankimues: “Elba – Oil 2015” SHA
Xibrakë, Labinot Fushë, Kantjeri midis fshatrave Mirake-Xibrake, Zona Kadastrale nr 3864, Elbasan

Autoriteti Kontraktor: Posta Shqiptare SHA
Rruga “Reshit Çollaku”, Nr. 4, Tiranë

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë

5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga 3 tre anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 21.10.2022, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “Procedurë e hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-46826-10-20-2022, me objekt: Loti II “Blerje Vaj, Antifrizë dhe Alkol për automjete”, me fond limit 1.030.000 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 04.11.2022 nga autoriteti kontraktor, Posta Shqiptare SHA.

II.2. Në datën 04.11.2022 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Në datën 10.11.2022, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të

Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

- | | |
|--------------------------|----------------------------|
| 1. “Elba - Oil 2015” SHA | 918.000 lekë, skualifikuar |
| 2. “B&A-02” SHA | 943.750 lekë, skualifikuar |
| 3. “Top Oil” SHA | 1.017.500 lekë kualifikuar |

Në datën 10.11.2022 operatori ekonomik “Elba - Oil 2015” SHA është njoftuar për skualifikimin e ofertës së tij ekonomike për arsyet si më poshtë:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit tekniko ligjor të ofertës së paraqitur në tender rezulton që nuk përmbush plotësisht kriteret ligjore dhe teknike për kualifikim dhe konkretisht:

Autoriteti Kontraktor “Posta Shqiptare” sh.a. te kriteret e vecanta të kualifikimit-pika 2.3.3 ku Operatori Ekonomik duhet të paraqesë fletë analiza ose skeda teknike për vajrat e kërkuara nga një laborator i akredituar ose nga ISHTI ka mospërputhje si më poshtë:

- *Për artikullin Vaj SAE 5Ë40 në fletën e analizës të paraqitur nga operatori ekonomik është fletë analize e vitit 2021 dhe nuk përmbush kushtin ku fleta e analizave duhet të jetë brënda viti 2022.*
Për artikullin Vaj 20Ë40 në fletën e analizës të paraqitur nga operatori ekonomik është fletë analize e vitit 2020 dhe nuk përmbush kushtin ku fleta e analizave duhet të jetë brënda vitit 2022.
- *Për artikullin Vaj SAE 10Ë40 në fletën e analizës të paraqitur nga operatori ekonomik ka mospërputhje të rezultateve të analizave me vlerat tipike të kërkuara në specifikimet teknike.*
- *Për artikullin Vaj SAE 20Ë40 në fletën e analizës të paraqitur nga operatori ekonomik ka mospërputhje të rezultateve të analizave me vlerat tipike të kërkuara në specifikimet teknike.*
- *Për artikullin Vaj SAE 80Ë90 në fletën e analizës të paraqitur nga operatori ekonomik ka mospërputhje të rezultateve të analizave me vlerat tipike të kërkuara në specifikimet teknike.*
- *Për artikullin Vaj SAE10 në fletën e analizës të paraqitur nga operatori ekonomik ka mospërputhje të rezultateve të analizave me vlerat tipike të kërkuara në specifikimet teknike.*
- *Për artikujt Antfreeze dhe Alkol frenash operatori ekonomik nuk ka paraqitur fletë analizash laboratorike.*

II.4. Në datën 21.11.2022, autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE “Publikimi i Njoftimit të fituesit” për procedurën e prokurimit.

II.5. Në datën 23.11.2022 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 2609/2022 protokolli, datë 15.11.2022 dhe me numër ankimi elektronik A/2022/2718 e operatorit ekonomik “Elba - Oil 2015” SHA ku u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së tij ekonomike të procedurës së mësipërme të prokurimit.

II.6. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe formularin për publikim Nr.2609/2 prot., datë 24.11.2022 lidhur me arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik “Elba - Oil 2015” SHA.

II.7. Nëpërmjet shkresës me nr. 2362/13 prot., datë 09.12.2022, protokolluar me tonën me nr. 2609/3 prot., datë 12.12.2022 me objekt “*Shqyrtim i ankesës nr.2609/2 prot., datë 24.11.2022*”, është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik akti i trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues, ku konstatohet, se autoriteti kontraktor ka refuzuar ankesën e operatorit ekonomik “Elba - Oil 2015” SHA.”
Gjithashtu me anë

II.8. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se operatorët ekonomikë të interesuar në këtë procedurë prokurimi, nuk kanë dorëzuar argumente në përputhje me nenin 113 të LPP-së, në formë shkresore apo në sistemin e ankesave elektronike.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “Elba - Oil 2015” SHA, se arsyet e skualifikimit të ofertës së tij ekonomike “- *Për artikullin Vaj SAE 5Ë40 në fletën e analizës të paraqitur nga operatori ekonomik është fletë analize e vitit 2021 dhe nuk përmbush kushtin ku fleta e analizave duhet të jetë brënda viti 2022.*

-Për artikullin Vaj 20Ë40 në fletën e analizës të paraqitur nga operatori ekonomik është fletë analize e vitit 2020 dhe nuk përmbush kushtin ku fleta e analizave duhet të jetë brënda vitit 2022.

- Për artikullin Vaj SAE 10Ë40 në fletën e analizës të paraqitur nga operatori ekonomik ka mosperputhje të rezultateve të analizave me vlerat tipike të kërkuara në specifikimet teknike.

- Për artikullin Vaj SAE 20Ë40 në fletën e analizës të paraqitur nga operatori ekonomik ka mosperputhje të rezultateve të analizave me vlerat tipike të kërkuara në specifikimet teknike.

- Për artikullin Vaj SAE 80Ë90 në fletën e analizës të paraqitur nga operatori ekonomik ka mosperputhje të rezultateve të analizave me vlerat tipike të kërkuara në specifikimet teknike.

- Për artikullin Vaj SAE10 në fletën e analizës të paraqitur nga operatori ekonomik ka mosperputhje të rezultateve të analizave me vlerat tipike të kërkuara në specifikimet teknike.”, nuk qëndrojnë, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në Shtojcën 7 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika 2.3 “Kapaciteti teknik”, pika 2.3.3 e dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi të publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike nga autoriteti kontraktor, përcaktohet kriteri si më poshtë:

2.3.3 Operatori ofertues duhet të paraqesë raport analizat të lëshuar nga Inspektoriat Shtetëror Teknik Industrial (ISHTI) / raport testimi/skede teknike për vajrat e kërkuar në shtojcën 5, ose nga një laborator i akredituar, ku vlerat e treguesve të analizuar të përputhen me vlerat në specifikimet e kërkuara nga autoriteti kontraktor. Raport analiza duhet të jetë lëshuar brenda vitit 2022. Akreditimi të jetë i vlefshëm nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtare Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

III.1.2. Në shtojcën 5, “Formulari I Specifikimeve Teknike”, të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet si më poshtë:

Shtojca 5

Loti i II-të “Blerje Vaj, Antifrizë dhe Alkol për automjete”,

VAJ, ANTIFREEZE, ALKOOL

1 - Artikujt të paraqiten me fletë-analizat laboratorike

2 - Fletë-analizat duhet të jenë të lëshuara nga nja laborator i akredituar ose nga ISHTI

3 - Artikujt të përmbushin parametrat si më poshtë:

VAJ SAE 5W40

<i>Karakteristikat</i>	<i>Metoda</i>	<i>Njësia</i>	<i>Vlerat tipike</i>
<i>Densiteti në 15°C</i>	<i>ASTM D 7042-21</i>	<i>g/cm³</i>	<i>0.856-0.861</i>
<i>Densiteti në 20°C</i>	<i>ASTM D 7042-21</i>	<i>g/cm³</i>	<i>0.853-0.857</i>
<i>Viskoziteti Kinematik në 40°C</i>	<i>ASTM D 7042-21</i>	<i>mm²/s</i>	<i>84.2-88.1</i>
<i>Viskoziteti Kinematik në 100°C</i>	<i>ASTM D 7042-21</i>	<i>mm²/s</i>	<i>12.5-16.3</i>
<i>Indeksi i Viskozitetit</i>	<i>ASTM D 2270-10</i>	<i>-</i>	<i>≥115</i>
<i>Temperatura e Flakërimit</i>	<i>ASTM D 92-18</i>	<i>°C</i>	<i>≥210</i>
<i>Temperatura e Ngrirjes</i>	<i>ASTM D 97-17b</i>	<i>°C</i>	<i>≤-30</i>
<i>TBN</i>	<i>ASTM D 2896-15</i>	<i>mgKOH/g</i>	<i>≥5</i>
<i>Përmbajtja e Hirit</i>	<i>ASTM D 874-13a</i>	<i>%</i>	<i>≤1.2</i>

VAJ SAE 10W40

<i>Karakteristikat</i>	<i>Metoda</i>	<i>Njësia</i>	<i>Vlerat tipike</i>
<i>Densiteti në 15°C</i>	<i>ASTM D 7042-21</i>	<i>g/cm³</i>	<i>0.855-0.859</i>
<i>Densiteti në 20°C</i>	<i>ASTM D 7042-21</i>	<i>g/cm³</i>	<i>0.852-0.856</i>
<i>Viskoziteti Kinematik në 40°C</i>	<i>ASTM D 7042-21</i>	<i>mm²/s</i>	<i>88.2-92.1</i>
<i>Viskoziteti Kinematik në 100°C</i>	<i>ASTM D 7042-21</i>	<i>mm²/s</i>	<i>12.5-16.3</i>
<i>Indeksi i Viskozitetit</i>	<i>ASTM D 2270-10</i>	<i>-</i>	<i>≥125</i>
<i>Temperatura e Flakërimit</i>	<i>ASTM D 92-18</i>	<i>°C</i>	<i>≥200</i>
<i>Temperatura e Ngrirjes</i>	<i>ASTM D 97-17b</i>	<i>°C</i>	<i>≤-32</i>
<i>TBN</i>	<i>ASTM D 2896-15</i>	<i>mgKOH/g</i>	<i>≥7.5</i>

<i>Përmbajtja e Hirit</i>	<i>ASTM D 874-13a</i>	<i>%</i>	<i>≤1.3</i>
---------------------------	-----------------------	----------	-------------

VAJ SAE 20W40

<i>Karakteristikat</i>	<i>Metoda</i>	<i>Njësia</i>	<i>Vlerat tipike</i>
<i>Densiteti në 15°C</i>	<i>ASTM D 7042-16</i>	<i>g/cm³</i>	<i>0.879-0.884</i>
<i>Densiteti në 20°C</i>	<i>ASTM D 7042-16</i>	<i>g/cm³</i>	<i>0.877-0.881</i>
<i>Viskoziteti Kinematik në 40°C</i>	<i>ASTM D 7042-16</i>	<i>mm²/s</i>	<i>106.8-109.2</i>
<i>Viskoziteti Kinematik në 100°C</i>	<i>ASTM D 7042-16</i>	<i>mm²/s</i>	<i>14.0-16.3</i>
<i>Indeksi i Viskozitetit</i>	<i>ASTM D 2270-10</i>	<i>-</i>	<i>≥120</i>
<i>Temperatura e Flakërimet</i>	<i>ASTM D 92-18</i>	<i>°C</i>	<i>≥210</i>
<i>Temperatura e Ngrirjes</i>	<i>ASTM D 97-17b</i>	<i>°C</i>	<i>≤-30</i>
<i>TBN</i>	<i>ASTM D 2896-15</i>	<i>mgKOH/g</i>	<i>≥7.5</i>
<i>Përmbajtja e Hirit</i>	<i>ASTM D 874-13a</i>	<i>%</i>	<i>≤1.5</i>

VAJ SAE 80W90

<i>Karakteristikat</i>	<i>Metoda</i>	<i>Njësia</i>	<i>Vlerat tipike</i>
<i>Densiteti në 15°C</i>	<i>ASTM D 7042-21</i>	<i>g/cm³</i>	<i>0.887-0.891</i>
<i>Densiteti në 20°C</i>	<i>ASTM D 7042-21</i>	<i>g/cm³</i>	<i>0.884-0.888</i>
<i>Viskoziteti Kinematik në 40°C</i>	<i>ASTM D 7042-21</i>	<i>mm²/s</i>	<i>162-168</i>
<i>Viskoziteti Kinematik në 100°C</i>	<i>ASTM D 7042-21</i>	<i>mm²/s</i>	<i>13.5-18.5</i>
<i>Indeksi i Viskozitetit</i>	<i>ASTM D 2270-10</i>	<i>-</i>	<i>≥100</i>
<i>Temperatura e Flakërimet</i>	<i>ASTM D 92-18</i>	<i>°C</i>	<i>≥220</i>
<i>Temperatura e Ngrirjes</i>	<i>ASTM D 97-17b</i>	<i>°C</i>	<i>≤-30</i>

VAJ SAE 10

<i>Karakteristikat</i>	<i>Metoda</i>	<i>Njësia</i>	<i>Vlerat tipike</i>
<i>Densiteti në 15°C</i>	<i>ASTM D 7042-21</i>	<i>g/cm³</i>	<i>0.881-0.885</i>
<i>Densiteti në 20°C</i>	<i>ASTM D 7042-21</i>	<i>g/cm³</i>	<i>0.885-0.889</i>
<i>Viskoziteti Kinematik në 40°C</i>	<i>ASTM D 7042-21</i>	<i>mm²/s</i>	<i>38.1-41.9</i>
<i>Viskoziteti Kinematik në 100°C</i>	<i>ASTM D 7042-21</i>	<i>mm²/s</i>	<i>5.5-9.3</i>
<i>Indeksi i Viskozitetit</i>	<i>ASTM D 2270-10</i>	<i>-</i>	<i>≥90</i>
<i>Temperatura e Flakërimet</i>	<i>ASTM D 92-18</i>	<i>°C</i>	<i>≥170</i>
<i>Temperatura e Ngrirjes</i>	<i>ASTM D 97-17b</i>	<i>°C</i>	<i>≤-27</i>

ANTIFREEZE

<i>Karakteristikat</i>	<i>Metoda</i>	<i>Njësia</i>	<i>Vlerat tipike</i>
<i>Densiteti Relativ në 20°C (koncentrat)</i>	<i>ASTM D 1122</i>	<i>-</i>	<i>1.120-1.125</i>
<i>pH (50% ujë në volum)</i>	<i>ASTM D 1287</i>	<i>-</i>	<i>6.5-7.5</i>
<i>Pika e Ngrirjes (50% ujë në volum)</i>	<i>ASTM D 1177</i>	<i>°C</i>	<i>≤-38</i>
<i>Pika e Vlimit (koncentrat)</i>	<i>ASTM D 1120</i>	<i>°C</i>	<i>≥165</i>

ALKOL FRENASH

<i>Karakteristikat</i>	<i>Metoda</i>	<i>Njësia</i>	<i>Vlerat tipike</i>
<i>Densiteti në 20°C</i>	<i>EN ISO 3675</i>	<i>g/cm³</i>	<i>0.060-1.066</i>
<i>Viskoziteti Kinematik në 40°C</i>	<i>EN ISO 3104</i>	<i>mm²/s</i>	<i>≤1800</i>
<i>Viskoziteti Kinematik në 100°C</i>	<i>EN ISO 3104</i>	<i>mm²/s</i>	<i>≥1.5</i>

<i>pH</i>	<i>ISO 4925</i>	-	<i>7.0-11.5</i>
<i>Pika e Vlimit (ERBP)</i>	<i>ISO 4925</i>	<i>°C</i>	<i>≥230</i>
<i>Pika e Vlimit (enë e hapur)</i>	<i>ISO 4925</i>	<i>°C</i>	<i>≥130</i>
<i>Stabiliteti në Temperaturë të Lartë</i>	<i>ISO 4925</i>	<i>°C</i>	<i>±5</i>

III.1.3. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se operatori ekonomik “Elba - Oil 2015” SHA në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Raport Analizimi para Zhdoganimit “Vajra Lubrifikantë”, datë 13.07.2021, për llojin e vajit “5W40”, lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial.
- Raport Testimi “Vajra lubrifikantë S SH ISO 8681:1986”, NR. 679/2. prot datë 01.02.2022, për llojin e vajit “10W40”, lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial.
- Raport Analizimi para Zhdoganimit “Vajra Lubrifikantë S SF ISO 8681:1986”, datë 04.02.2020, për llojin e vajit “20W40”, lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial.
- Raport Testimi “Vajra lubrifikantë S SH ISO 8681:1986”, NR. 679/4 prot. datë 01.02.2022, për llojin e vajit “80W90”, lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial.
- Raport Testimi “Vajra lubrifikantë S SH ISO 8681:1986”, NR. 679/4 prot. datë 01.02.2022, për llojin e vajit SAE 10W”, lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial.

III.1.4. Neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë.

III.1.5. Neni 40 pika 3 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave”, të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikohet shprehimisht se:

3.Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo 38 rast,

autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve.

III.1.6. Neni 40 pika 5 dhe 6 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave”, të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikohet shprehimisht se:

5. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

c) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike.

c) dëshmi për rezultatet e testeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

III.1.7. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Në rastin konkret, bazuar në specifikimet teknike (shih shtojca 5 formulari i specifikimeve teknike) të mallrave objekt-prokurimi, Komisioni gjykon, se për autoritetin kontraktor është tepër rëndësishme që të prokurojë mallra që plotësojnë specifikimet teknike, duke përcaktuar në mënyrë të detajuar të gjitha specifikimet teknike për mallrat/produktet objekt-prokurimi si dhe duke përcaktuar në kriterin e veçantë të kualifikimit (citojmë) “[...] Operatori ofertues duhet të paraqesë raport analizat të lëshuar nga Inspektorati Shtetëror Teknik Industrial (ISHTI) / raport testimi/skede teknike për vajrat e kërkuar në shtojcën 5, ose nga një laborator i akredituar, ku vlerat e treguesve të analizuar të përputhen me vlerat në specifikimet e kërkuara nga autoriteti kontraktor. Raport analiza duhet të jetë lëshuar brenda vitit 2022. Akreditimi të jetë i vlefshëm nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë [...]”. Referuar

kriterit të veçantë të kualifikimit rezulton, se është kërkuar shprehimisht që operatorët ekonomikë ofertues, duhet të paraqesin raport analizat të lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik Industrial (ISHTI) / raport testimi/ skede teknike për vajrat e kërkuar në shtojcën 5, ose nga një laborator i akredituar, ku vlerat e treguesve të analizuar të përputhen me vlerat në specifikimet e kërkuara nga autoriteti kontraktor. Raport analiza duhet të jetë lëshuar brenda vitit 2022. Gjithashtu, në shtojcën e publikuar për specifikimet teknike janë parashikuar specifikimet teknike në lidhje me produktet e kërkuara.

Nisur nga arsyet e skualifikimit, pretendimeve të ankimesit, si dhe nga shqyrtimi i dokumentave të dorëzuar në SPE nga operatori ekonomik “Elba – Oil 2015” SHA, konstatohet se ky i fundit në përmbushje të kriterëve të mësipërme, ka paraqitur Raport Testimi dhe Raport Analizimi para Zhdoganimit të lëshuara nga Inspektoriati Shtetëror Teknik Industrial (ISHTI), për produktet “Vajra Lubrifikantë” të kërkuar nga autoriteti kontraktor.

Nga verifikimi i këtij dokumentacioni, konstatohet se raport analizat e paraqitura për produktet Vajra Lubrifikantë të llojit 5W40 dhe Vajra Lubrifikantë të llojit 20W40, nuk janë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në pikën 2.3.3 të “Kritereve të Veçanta të Kualifikimit”, pasi nuk janë lëshuar brenda vitit 2022. Konkretisht, Raport Analizimi para Zhdoganimit “Vajra Lubrifikantë”, të llojit “5W40”, është lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial, në datë 13.07.2021. Ndërsa, Raport Analizimi para Zhdoganimit “Vajra Lubrifikantë S SF ISO 8681:1986”, për llojin e vajit “20W40”, është lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial në datë 04.02.2020.

Sa më sipër, këto dy dokumenta nuk janë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në pikën 2.3.3 të “Kritereve të Veçanta të Kualifikimit”, të dokumentave të tenderit.

Gjithashtu, nisur nga arsyet e skualifikimit dhe pretendimet e operatorit ekonomik ankimes, konstatohet se disa nga produktet e ofruara nuk janë në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara nga autoriteti kontraktor.

Konkretisht, për artikullin Vaj SAE 10W40, operatori ekonomik ankimes ka paraqitur në SPE dokumentin Raport Testimi “Vajra lubrifikantë S SH ISO 8681:1986”, NR. 679/2. prot datë 01.02.2022, për llojin e vajit “10W40”, lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial, i cili përmban specifikime teknike të cilat nuk përputhen me specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, konkretisht: Densiteti në 15°C, Viskoziteti kinematik në 40°C dhe Viskoziteti kinematik në 100°C.

Për artikullin Vaj SAE 20W40, operatori ekonomik ankimes ka paraqitur në SPE dokumentin Raport Analizimi para Zhdoganimit “Vajra Lubrifikantë S SF ISO 8681:1986”, datë 04.02.2020, për llojin e vajit “20W40”, lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial, i cili përveç faktit që është lëshuar gjatë vitit 2020 (në kundërshtim me pikën 2.3.3 të kriterëve të kualifikimit), gjithashtu përmban specifikime teknike të cilat nuk përputhen me specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, konkretisht: Densiteti në 15°C, Viskoziteti kinematik në 40°C, Viskoziteti kinematik në 100°C dhe Indeksi i viskozitetit.

Për artikullin Vaj SAE 80W90, operatori ekonomik ankimes ka paraqitur në SPE dokumentin Raport Testimi “Vajra lubrifikantë S SH ISO 8681:1986”, NR. 679/4 prot. datë 01.02.2022, për llojin e vajit “80W90”, lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial, i cili përmban specifikime teknike të cilat nuk përputhen me specifikimet teknike

të kërkuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, konkretisht: Densiteti në 15°C, Viskoziteti kinematik në 40°C, Viskoziteti kinematik në 100°C dhe Indeksi i viskozitetit.

Për artikullin Vaj SAE 10, operatori ekonomik ankimues ka paraqitur në SPE dokumentin Raport Testimi “Vajra lubrifikantë S SH ISO 8681:1986”, NR. 679/4 prot. datë 01.02.2022, për llojin e vajit SAE 10W”, lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial, i cili përmban specifikime teknike të cilat nuk përputhen me specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, konkretisht: Densiteti në 15°C dhe Indeksi i viskozitetit.

Sa më sipër konstatuar, referuar specifikimeve teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit për produktet e mësipërme, si dhe nga verifikimi i përmbushjes së këtyre specifikimeve në dokumentat e paraqitura nga operatori ekonomik “Elba - Oil 2015” SHA, konstatohet, se dokumentacioni i dorëzuar nga ky i fundit në SPE nuk përmban të gjitha elementet/specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor.

Akoma më tej, Komisioni i Prokurimit Publik sjell në vëmendje, se operatori ekonomik ka detyrimin të paraqesë ofertën e tij në përputhje me të gjitha kriteret dhe specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit. Komisioni sqaron, se nëse operatori ekonomik ankimues do të kishte pretendime në lidhje me kriteret/specifikimet teknike të vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, ka pasur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës lidhur me kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit, parashikuar nga neni 110 pika 1/1 e LPP. Në nenin 110 pika 1/1 të ligjit nr.162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, ku parashikohet se “*Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të kontratës ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.*”. Komisioni gjykon, se është detyrë e operatorëve ekonomikë të përgatisin ofertat e tyre në përputhje me kriteret dhe kushtet e vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, për sa kohë që i kanë pranuar ato dhe nuk i kanë bërë në asnjë rast objekt-ankimimi.

Sa më sipër, KPP gjykon, se disa nga raport testimet e paraqitura nga operatori ekonomik “Elba - Oil 2015” SHA, për produktet e mësipërme, nuk plotësojnë pikën 2.3.3 të “Kritereve të Veçanta të Kualifikimit”, si dhe nuk përmbushin të gjitha specifikimet e kërkuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit.

Rrjedhimisht, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues nuk qëndrojnë.

III.2. Lidhur me pretendimet e tjera të ngritura nga operatori ekonomik ankimues “Elba-Oil 2015” SHA, në procedurën e prokurimit objekt-ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se për sa kohë që pretendimet e mësipërme nuk qëndrojnë dhe operatori ekonomik ankimues nuk përmbush kriteret e veçanta të kualifikimit dhe specifikimet teknike, dhe gjendja e tij faktike juridike pas arsytimit të KPP mbetet e skualifikuar, shqyrtimi në themel i pretendimeve të tjera të palës ankimese nuk ndryshojnë gjendjen juridike të këtij operatori, e për rrjedhojë nuk do të merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Elba - Oil 2015” SHA për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-46826-10-20-2022, me objekt: Loti II “Blerje Vaj, Antifrizë dhe Alkol për automjete”, me fond limit 1.030.000 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 04.11.2022 nga autoriteti kontraktor, Posta Shqiptare SHA.
 2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
 3. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Elba - Oil 2015” SHA.
 4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri

